



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORT VJETOR





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

SKYTOWER

Rr. "Ibrahim Rugova"

Nr. 5, Ap 9/3

Tiranë

Përgatitur nga: Sekretariati i AAB-së

Design & Layout: Ladybird

Shtypi: Gentgrafik

Përmbajtja:

4	Mesazh nga Kryetari
7	Rreth Nesh
10	Sektori Bankar Shqiptar në vitin 2014 - në shifra
12	Ndryshime Rregullatore
15	Aktivitetet e AAB-së
16	Komitetet Teknike
19	Takime të tjera
22	Edukimi Financiar
25	Trajnime dhe Seminare
31	Publikime
32	Bankat Anëtare - Fakte dhe Shifra
34	Pasqyrat Financiare për vitin 2014

> Mesazh nga Kryetari

I dashur Lexues,

Ekonomia shqiptare pati gjatë vitit 2014 një rimëkëmbje modeste me bazë të gjerë ekonomike, nxitur kryesisht nga eksportet, investimet dhe shenja inkurajuese përmirësimi të konsumit dhe investimeve private. Besimi i sektorit privat po përmirësohet, pjesërisht si pasojë e shlyerjes së borxheve të qeverisë ndaj bizneseve. Megjithatë, e vlerësuar në rreth 2.1%, rritja është ende nën potencial. Punësimi u rrit gjatë vitit të kaluar, por papunësia (13%) është ende e lartë ndërkohë që rritet edhe fuqia punëtore.

Totali i aktiveve të sistemit bankar u rrit me 4.8% krahasuar me një vit më parë, mbështetur kryesisht nga rritja e transaksioneve të thesarit dhe ato ndër-bankare, por me një kontribut të ndjeshëm edhe të rigjallërimit të kredidhënies në tremujorin e fundit të vitit 2014. Raporti i kredive ndaj depozitave është rreth 55%; një nivel i shëndetshëm për të gjithë sistemin, me shumë potencial për rritje të kreditimit të ekonomisë.

Niveli i kredive me probleme të sistemit u ul në 22.8% në dhjetor 2014 nga 23.5% në dhjetor 2013, në pothuaj të njëjtin nivel si në dhjetor 2012. Sektori bankar mori pak frymë falë injektimit të likuiditetit nëpërmjet shlyerjes së pagesave të vonuara të qeverisë. Mendojmë se pa këto pagesa situata e kredive me probleme do të ishte më keq.

Sistemi bankar pati një rezultat pozitiv prej 79.9 milion Euro fitim neto, rezultati më i mirë që prej vitit 2007.

Tashmë kemi një Guvernator të ri: Shoqata e mirëpriti Z. Gent Sejko dhe ndau me të të njëjtin opinion në takimin e përbashkët, për të vijuar bashkëpunimin dhe partneritetin e suksesshëm të ndërtuar tashmë.

Shoqata Shqiptare e Bankave mbetet optimiste për vitin 2015. Rritja e PBB-së pritet të përshpejtohet në 3%, bazuar në ringjalljen e moderuar të kërkesës së brendshme, rritje të IHD-ve dhe një politikë monetare lehtësuese. Sektori i energjisë pritet të përmirësohet, ndërsa investime të mëdha si projekti TAP, hidrocentrali i Devollit dhe ndërtimi i rrugës së Arbrit, priten të fillojnë gjatë katër viteve të ardhshme. Këtë vit maturohet Eurobondi



shqiptar 300 milionë euro dhe qeveria do t'u drejtohet sërish tregjeve, e favorizuar tashmë nga statusi i vendit kandidat në BE dhe vlerësimi i përmirësuar i S&P nga i "qëndrueshëm" në "pozitiv".

Shoqata do të luajë një rol të rëndësishëm në dhënien e opinioneve mbi paketën fiskale të vitit 2016, dhe konsolidimin e rolit të saj si përfaqësuese e rëndësishme e interesave të komunitetit bankar. Ne do të vijojmë të përqendrohemi tek trajnimet dhe përgjegjshmëria sociale e korporatës, pasi unë mendoj se është vërtetë e rëndësishme të kujdesemi për komunitetin, konsumatorët dhe stafin.

Së fundmi, dëshiroj të falënderoj paraardhësin tim, të gjithë kolegët e mi dhe stafin e Shoqatës për punën dhe përkushtimin e tyre.

Me respekt,

Christian CANACARIS

KRYETAR



> Bordi Drejtues i AAB-së

(DERI NË QERSHOR 2015)



Z. Christian CANACARIS
KRYETAR
Drejtor i Përgjithshëm,
BANKA RAIFFEISEN
SHQIPËRI



Z. Gazmend KADRIU
ZËVENDËS KRYETAR
Drejtor i Përgjithshëm,
UNION BANK



Z. Frédéric BLANC
ANËTAR
Drejtor i Përgjithshëm,
SOCIETE GENERALE
ALBANIA



Z. Periklis DROUGKAS
ANËTAR
Drejtor i Përgjithshëm,
ALPHA BANK ALBANIA



Z. Seyhan PENCABLIGIL
ANËTAR
Drejtor i Përgjithshëm,
BANKA KOMBËTARE
TREGTARE



Z. Bozhidar TODOROV
ANËTAR
Drejtor i Përgjithshëm,
FIBANK SHQIPËRI

> ANËTARËSIMET E AAB-së


AAB është anëtare me të drejta të plota, anëtare e asociuar, ose partnere, e organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare, si më poshtë:

i. Anëtarësimet Ndërkombëtare

- Federata Evropiane e Bankave (EBF)
- Forumi Ndër-Ballkanik i Shoqatave të Bankave
- Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
- OECD Rrjeti Ndërkombëtar mbi Edukimin Financiar (INFE)
- Shoqata Evropiane e Trajnimeve Bankare & Shërbime Financiare (EBTN)
- Agjencia e Transferimit të Teknologjisë Financiare (ATTF)

ii. Anëtarësimet Kombëtare

- Këshilli Ekonomik Kombëtar
- Këshilli Tatimor
- ICC Albania - Komiteti Kombëtar i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC)
- Këshilli Kombëtar i Punës
- Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA)



> SEKRETARIATI



Zj. Endrita XHAFERAJ
Sekretare e Përgjithshme



Zj. Brunilda KOSTARE
Këshilltare Ligjore



Zj. Junida TAJFAJ
Oficere e Operacioneve



Zj. Eftali PEÇI
Specialiste
e Komunikimit



Zj. Marsela BULKU
Asistente
Administrative

> KOMITETE TEKNIKE TË AAB-së

(DERI NË QERSHOR 2015)

1 Komiteti i Auditorëve të Brendshëm

2 Komiteti i Burimeve Njerëzore

3 Komiteti i Kartave

4 Komiteti i Komunikimit

5 Komiteti i Përputhshmërisë

6 Komiteti i Sigurisë Bankare

7 Komiteti i Sigurisë së Informacionit

8 Komiteti i Sistemeve të Pagesave

9 Komiteti i Thesarit & Tregjeve Financiare

10 Komiteti Ligjor

> SEKTORI BANKAR SHQIPTAR

NJË PAMJE E PËRGJITHSHME MBI SEKTORIN

16 

BANKA ME KAPITAL
TË GJITHIN PRIVAT



71%

KAPITAL NGA EU

TOTALI I AKTIVEVE

1,293 miliardë **Lekë**

+ 4.8 %

RRITJE NGA 2013

91.6 % E **PBB-së**

TOTALI I DEPOZITAVE

1,072 miliardë **Lekë**

+4.5 %

RRITJE NGA 2013

75.9 % E **PBB-së**

KAPITALI I AKSIONERËVE

110.9 miliardë **Lekë**

+7.4% RRITJE NGA 2013

RAPORTI I LIKUIDITETIT

40.4 %

RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

16.8 %


RAPORTI I KREDIVE ME PROBLEME NDAJ TOTALIT TË KREDISË

22.8 %

-0.7 PIKË PËRQINDJE NGA 2013

VITI 2014 NË SHIFRA

FINANCIIMI PËR EKONOMINË SHQIPTARE NË 2014



MBULIM ME INFRASTRUKTURË MODERNE DHE EFIKASE

DEGË DHE AGJENCI TË BANKAVE:

527

PIKA TËRHEQJE PARASH (ATM)

811

PAJISJE SHITJE NË DYQANE E BIZNESE (POS)

6,540

KARTA DEBITI DHE KREDITI NË QARKULLIM

862,019

7% rritje NGA 2013

TRANSAKSIONE ME KARTA

VOLUMI 13,685,958

VLERA: 136.1 MILIARDË LEKË

4.6% rritje NGA 2013

TRANSAKSIONE BANKARE NË INTERNET

VOLUMI 1,249,294

4 herë më shumë SE 2013

VLERA: 164.5 MILIARDË LEKË

63% rritje NGA 2013

Të dhënat për fundin e vitit 2014 / Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë, dhe përllogaritje të AAB

> NDRYSHIME NË LEGJISLACION



Gjatë viteve të fundit, kuadri rregullator dhe legjislativ në Shqipëri ka pësuar ndryshime të vazhdueshme. Edhe në vitin 2014, pati amendime të rëndësishme të këtij kuadri, me efekt mbi aktivitetin e bankave, si nga këndvështrimi i mbikëqyrjes dhe rregullimit të vepërimitarisë së tyre në veçanti, ashtu edhe në një shkallë më të gjerë, në drejtim të politikave dhe procedurave fiskale.

I

RREGULLORET E BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi gjatë vitit 2014 disa Rregullore të reja si dhe ndryshime ato ekzistueset si më poshtë:

- 26 shkurt 2014 - **Rregullorja "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"**. AAB ishte pjesë e procesit të konsultimit për këtë Rregullore, që u diskutua nga drejtorët e departamenteve të rrezikut të bankave, dhe Komiteti i AAB-së i Thesarit dhe Tregjeve Financiare. Bazuar në sugjerimet dhe komentet e tyre AAB bëri disa propozime, një pjesë e mirë e të cilave u reflektuan në fillim të vitit 2015.

& KUADRIN RREGULLATOR

- 26 shkurt 2014 - **Udhëzim “Mbi Planet e Rimëkëmbjes”**, objekt i të cilit është përcaktimi i parimeve dhe kërkesave mbikëqyrëse mbi strukturën dhe përmbajtjen e Planeve të Rimëkëmbjes së bankave dhe raportimin e tyre në Bankën e Shqipërisë.
- 26 shkurt 2014 - **Ndryshime në Rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”**, që u ndërmorën mbi nenet që rregullojnë klasifikimin e kredive, dhe detyrimin për bankat për fshirjen e kredive me probleme prej më shumë se 3 vjetësh. Bankat shprehën kundërshtimin ndaj këtij ndryshimi në takime dhe komunikime me Bankën e Shqipërisë.
- 27 mars 2014 - **Udhëzimi Nr. 2 “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka”**. Ky udhëzim përcakton procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të shumave në llogaritë bankare. AAB dhe Komiteti i saj Ligjor ishin pjesë e procesit të konsultimit, por shumë pak prej komenteve të bankave u morën në konsideratë në draftin përfundimtar.
- 25 qershor 2014 - **Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave”**. Qëllimi i këtij Komiteti është të mbështesë dhe kontribuojë në forcimin e sigurisë, stabilitetit dhe efektivitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. AAB është anëtare e përhershme e këtij Komiteti, përfaqësuar nga Kryetari i Komitetit të saj të Pagesave.
- 25 qershor 2014 - **Ndryshime në Rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”**, që prekin disa nga përkufizimet e rregullores, si dhe i shtojnë asaj një nen që rregullon remunerimin e tepicës në llogarinë e rezervës së detyruar.
- 30 korrik 2014 - **Ndryshime në Rregulloren “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”**, me shtimin e Aneksit 7, që përmban formularët raportues të kërkesave për kapital (COREP) dhe udhëzuesin metodologjik për plotësimin e tyre. Ndryshime të mëtejshme në këtë Rregullore u bënë në dhjetor 2014, në nenin 6, i cili rregullon ekspozimet e ponderuara me rrezik, si dhe në format e raportimit në Aneksin 7 dhe 8. AAB ishte pjesë e procesit të konsultimit, me komente dhe sugjerime të sistemit bankar dhe organizimin e takimeve të diskutimit.
- 1 tetor 2014 - **Ndryshime në Rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”**, që prekën nenet që rregullojnë: hapjen e degës, filialit, agjencisë ose zyrës së përfaqësimit; ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese; kërkesat për dokumentacionin në lidhje me miratime të tjera paraprake; kërkesat mbi detyrimet për njoftim, etj..
- 18 dhjetor 2014 - **Rregullorja Nr. 69 “Për kapitalin rregullator të bankës”**. Rregullorja e re trajton kërkesat e autoritetit mbikëqyrës kryesisht lidhur me: përcaktimin e komponenteve të strukturës, dhe metodës për llogaritjen, të kapitalit rregullator dhe nivelin e tij minimal; komponentët e kategorive të nivelit të parë dhe nivelit të dytë të kapitalit; kriteret kryesore për njohjen e instrumenteve të kapitalit; filtrat prudencialë të treguesve të kapitalit; etj.. AAB ishte pjesë e procesit të konsultimit me komentet dhe sugjerimet e bankave, dhe kërkoi shtyrjen e hyrjes në fuqi të Rregullores nga 1.1.2015 në 31.3.2015, kërkesë e cila u mor parasysh.
- 18 dhjetor 2014 - **Udhëzimi Nr. 3241, “Për sigurimin e depozitave në banka”**, që përcakton kushtet, procedurat dhe afatet për: anëtarësimin e bankave në skemën e sigurimit të depozitave; vlerësimin e shumës së depozitave të siguruara, kompensimit, kontributeve dhe primeve të sigurimit; shkëmbimin e informacionit, etj., veçanërisht lidhur me automatizimin e raportimit të bankave ndaj Agjencisë. AAB ishte pjesë e procesit të konsultimit, me komente dhe sugjerime nga sistemi bankar, shumica e të cilave u reflektuan në draftin përfundimtar.

- **Tatimi mbi Vlerën e Shtuar** - Gjatë pjesës së parë të vitit 2014, Ministri i Financave miratoi disa herë ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 17 të datës 13 maj 2008 "Mbi tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, ku një ndryshim me efekt për bankat ishte ai për përcaktimin e procedurave të rimbursimit të TVSH për tu kryer nga tatimpaguesit dhe autoritetet tatimore.

Në korrik 2014, Parlamenti shqiptar miratoi një Ligj të ri "Mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i cili hyri në fuqi më 1 janar 2015. Qëllimi i Ligjit të ri është të harmonizojë legjisllacionin shqiptar mbi TVSH me direktivat e Bashkimit Evropian dhe të rregullojë në detaje shumë aspekte të pashprehura specifikisht në ligjin ekzistues. AAB dërgoi për autoritetet komentet e sistemit bankar për përjashtimin nga TVSH të një listë shërbimeve bankare, por këto komente nuk u reflektuan në ligjin e miratuar.

- **Tatimi mbi të ardhurat** - Parlamenti miratoi dy herë amendamente mbi Ligjin gjatë vitit. Në prill 2014 u ndërmor një amendament i rëndësishëm për bankat, i kërkuar me këmbëngulje nga AAB, në nenin që rregullon njohjen e borxheve të këqija. Ky ndryshim njih fshirjen e borxheve të këqija si shpenzim të zbritshëm për bankat, degët e bankave të huaja dhe institucionet financiare jo-banka, me plotësimin e kushteve dhe afateve të përcaktuara lidhur me fillimin e procedurave të ekzekutimit.

Në nëntor, të tjera ndryshime u ndërmorën mbi Ligjin për aspekte të ndryshme, ndër të cilat më e rëndësishme ishte rritja e tatimit mbi të ardhurat personale të individëve (të ardhura të tjera të përveç pagës) nga 10% në 15%, duke filluar nga 1 janar 2015. Ky ndryshim prek, ndër të tjera, edhe të ardhurat nga interesat mbi depozitat bankare.

- **Këshilli Ekonomik Kombëtar** - Në qershor 2014, Parlamenti miratoi Ligjin Nr. 57/2014 për funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar (KEK), me qëllim garantimin e bashkëpunimit institucional dhe partneritetit publik-privat për zhvillimin e politikave ekonomike, garantimin e dialogut dhe këshillimit mes të autoriteteve të administratës publike dhe sektorit privat, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen publike dhe përfaqësimin e sektorit privat në këtë proces. AAB është anëtare e këtij Këshilli, përfaqësuar nga Kryetari i saj.
- **"Për sigurimin e depozitave"** - Ligji i ri u miratua nga Parlamenti në maj 2014. Ai rregullon funksionimin e skemës së sigurimit të depozitave për bankat, si edhe, sipas ndryshimeve të fundit, për unionet e kursim kreditit në Republikën e Shqipërisë. AAB ishte pjesë e procesit të konsultimit nëpërmjet komiteteve të saj teknike, duke paraqitur komentet dhe sugjerimet e sistemit bankar, disa nga të cilat janë marrë parasysh në ligjin e miratuar.
- **Transferimi i çmimit** - Parlamenti miratoi në qershor ndryshimet në Ligjet ekzistues mbi Tatimin mbi të Ardhurat dhe Procedurat Tatimore për të përfshirë në to dispozita në lidhje me transferimin e çmimit, që tashmë rregullohet në mënyrë më të detajuar, shoqëruar edhe me masa përkatëse.
- Vendim Nr. 457 për **"Ndryshimin e pagës minimale dhe maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore"** - miratuar nga Këshilli i Ministrave në korrik 2014, për rritjen e pagës minimale dhe maksimale mujore për llogaritjen e kontributeve. Paga minimale mujore mbi të cilën do të llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është 19,406 lekë, ndërsa paga maksimale 97,030 lekë.
- **"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"** - Në dhjetor 2014 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ndryshime në Ligjin për Procedurat Tatimore, dhe në Udhëzimin përkatës, lidhur kryesisht me: kërkesat për tatimpaguesit për rimbursimin e detyrimeve tatimore; garancinë e lëshuar për apelimet tatimore si dhe kushtet kohore në lidhje me këto apeline; gjobat për pagesa të vonuara tatimore dhe deklarate tatimore të pasakte, etj.; komunikimin elektronik për taksat ndërmjet autoriteteve tatimore dhe tatimpaguesve; etj..

> AKTIVITETET E AAB-së



I KOMITETET TEKNIKE

Seksioni i mëposhtëm përmbledh çështjet kryesore të trajtuara nga Komitetet Teknike të AAB-së gjatë vitit 2014. Në total, Komitetet e AAB-së dhe grupet e punës të krijuar brenda e midis tyre u mbledhën në **44 takime** përgjatë vitit 2014, mes tyre si edhe me autoritete të tjera, si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Drejtoria e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, etj. për të diskutuar dhe ndarë eksperiencat mbi çështje si operacionale ashtu edhe ligjore, të cilat u ndoqën në vijim nga Sekretariati i AAB-së.

I. KOMITETI I AUDITORËVE TË BRENDSHËM TË BANKAVE

Gjatë vitit 2014, Komiteti i përqendroi diskutimet mbi ndryshimet më të fundit në profesionin e auditimit bankar dhe nevojën për një qasje tjetër, bazuar mbi vlerësimin e rrezikut, për auditimin e aktiviteteve bankare. Në këtë drejtim, anëtarët e Komitetit theksuan domosdoshmërinë për ndryshime në rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi Sistemet e Kontrollit të Brendshëm, veçanërisht në lidhje me frekuencën (dy vjet) për kontrollin e plotë të brendshme. Komiteti gjithashtu diskutoi dhe punoi mbi një sërë ndryshimesh për tu propozuar për zbatimin e të paktën disa nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm

në sektorin bankar shqiptar. Këto propozime iu drejtuan Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, që mirëpriti iniciativën dhe informoi se Rregullorja do të rishikohet gjatë vitit 2015, në konsultim me AAB dhe Komitetin e Auditorëve të Brendshëm.

Komiteti forcoi më tej marrëdhëniet me Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm (AIIA), si në iniciativat e mësipërme dhe në bashkë-organizimin e trajnimeve, ashtu edhe në angazhimin për të bashkëpunuar për organizimin e një Forumi Kombëtar për Auditimin e Brendshëm, gjatë vitit 2015.

II. KOMITETI I SIGURISË BANKARE

Komiteti pati gjatë vitit 4 takime si dhe organizoi Forumin e Sigurisë Bankare. Anëtarët e tij u angazhuan në diskutime dhe sugjerime për projektligjin "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", të cilat iu dërguan Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në një material të unifikuar nga Sekretariati i AAB-së. Kryesia Komiteti përfaqësoi qëndrimin e bankave mbi këtë projekt, në takimin e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ku ligji u diskutua me aktorët e ndryshëm dhe palët kryesore të interesit lidhur me të. Kryesia e Komitetit takoi gjithashtu Drejtorët e

rinj të caktuar në Drejtoritë e Policisë së Shkodrës dhe Tiranës, për të krijuar ura komunikimi, për të prezantuar Komitetin si dhe për të theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë mes palëve. Pas një grabitjeje pranë njëres nga bankat anëtare, në qershor, Komiteti këshilloi të gjitha bankat anëtare për intensifikimin e bashkëpunimit me Shoqëritë e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike; aplikimin e sigurimeve të veçanta të jetës për punonjësit me ekspozimit të lartë ndaj rrezikut; planifikimin e masave të veçanta sigurie në raste të tilla si mbledhje bordesh; si dhe zhvillimin e programeve të trajnimit.

III. KOMITETI I KARTAVE

Gjatë viteve të fundit, Komiteti e ka zhvendosur fokusin në drejtim të çështjeve të zhvillimit të biznesit të kartave, më shumë se vetëm në parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit me karta, çka u reflektua në ndryshimin e emrit të tij (më parë Komiteti Kundër Mashtrimit me Karta).

teti Kundër Mashtrimit me Karta).

Me largimin e Kryetares së mëparshme anëtarët e Komitetit bënë zgjedhjet për Kryesinë e re, që tashmë përbëhet nga Kryetarja, zj. Imelda Kocaj nga BKT, and zv/Kryetarë zj. Monika Ballta nga Tirana

Bank dhe z. Erion Maxhari nga Fibank Shqipëri. Në tre takimet e organizuara gjatë vitit, anëtarët e Komitetit diskutuan dhe punuan mbi një nismë të re për të mbledhur të dhëna të agreguara mbi transaksionet e pagesave me karta (që do të shpërndahen

nga AAB në vitin 2015). Ata diskutuan gjithashtu edhe mbi rastet apo tentativat e mashtrimit të raportuara; mbi kalendarin e trajnimit për vitin 2015; dhe mbi iniciativa të mëtejshme për tu ndërmarrë në lidhje me edukimin e konsumatorit.

IV. KOMITETI I PËRPUTHSHMËRISË

Komiteti i Përputhshmërisë diskutoi gjatë vitit 2014 çështje të ndryshme lidhur me zbatimin e drejtë të kërkesave të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", si dhe mbi raportimin nga bankat të transaksioneve cash në vlera të larta dhe të pazakonta.

Komiteti pati në fokus gjatë këtij viti zbatimin e projektit FATCA në Shqipëri, dhe veçanërisht mbajtjen e një qasjeje të unifikuar nga të gjitha bankat anëtare, duke e diskutuar këtë çështje edhe me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Ambasadën e SHBA në Tiranë.

Duke vazhduar traditën e mirë të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Bankën e Shqipërisë, AAB organizoi gjatë vitit tre tryeza diskutimi të anëtarëve të Komitetit me këto institucione, me qëllim: përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e numrit të raportimeve të aktiviteteve të dyshimta nga bankat; rritja e kujdesit të duhur nga bankat; diskutimi i tipologjive të reja të pastrimit të parave të hasura nga bankat dhe autoritetet si edhe shqetësime të tjera të përbashkëta.

V. KOMITETI I BURIMEVE NJERËZORE

Komiteti u mbledh dy herë gjatë vitit, ndërkohë që përdori më së shumti komunikimin me email në formën e një forumi elektronik. Përveç pjesëmarrjes (për të tretin vit radhazi) në Vrojtimin mbi Pagat të kryer nga Hay Group, dhe përdorimit të rezultateve të tij, anëtarët e Komitetit vijuan të kontribuonin për popullimin e bazës me dhëna për treguesit kryesorë të HR nëpërmjet Sekretariatit të AAB-së, duke përdorur raportet e prodhuara për qëllime të brendshme në bankat individuale. Sekretariati i

AAB-së bashkëpunoi me departamentin e Burimeve Njerëzore në BKT për të përpunuar të dhënat për dy raportet e treguesve për vitin 2014.

Një temë e rëndësishme diskutimeve të Komitetit gjatë vitit ishte organizimi i trajnimeve më të mira dhe profesionale. Sekretariati i AAB-së bashkëpunoi me të gjithë anëtarët për organizimin më mirë të trajnimeve në vend dhe zgjedhjen e ekspertëve më profesionalë në fushat e kërkuara.

VI. KOMITETI I SIGURISË SË INFORMACIONIT

Gjatë tremujorit të dytë Komiteti diskutoi mbi zgjidhjet e mundshme që bankat duhet të konsiderojnë pas përfundimit të mbështetjes për Windows XP, që është sistemi operativ i më shumë se 65% të ATM-ve në botë. Anëtarët e Komitetit theksuan se të gjitha zgjidhjet e për tu konsideruar duhet të jenë në përputhje me PCI DSS dhe të bazuara në analizën e rrezikut që secila bankë duhet të kryejë individualisht.

Takimi i fundit i Komitetit u organizua me kërkesën e Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), i cili prezantoi projekt-Dokumentin e Politikave për Sigurinë

Kompjuterike, dhe diskutoi me anëtarët e Komitetit strukturën e tij dhe procedurat ku përfshihen palët. Përfaqësuesit e ALCIRT theksuan se kontributi i komunitetit bankar është shumë i rëndësishëm, duke qenë se bankat janë subjekte kritike të këtij Dokumenti. Anëtarët e Komitetit këshilluan përfaqësuesit e ALCIRT të mos përfshijnë në këtë Dokument standarde të cilat nuk zbatohen nga institucionet shtetërore, dhe janë shumë larg standardeve shqiptare. Drejtori i ALCIRT garantoj se Komiteti i Sigurisë së Informacionit i AAB-së do të jetë pjesë e grupit të punës që do të hartojë Ligjin për Sigurinë Kompjuterike.

VII. KOMITETI LIGJOR

Komiteti Ligjor i AAB-së trajtoi gjatë vitit një numër të madh çështjesh të lidhura me legjislativonin dhe zbatimin e tij. Temat kryesore në diskutim ishin si më poshtë:

- Shqetësimet e bankave lidhur me procedurat në Zyrat e Regjistrimit të cilat iu adresuan me një shkresë në janar Kryeregjistruesit të ri të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në përgjigjen e marrë në shkurt, Kryeregjistruesi i pranoi çështjet e ngritura nga AAB, dhe u kërkoi të gjitha zyrtarëve vendore heqjen e pengesave në dokumentacionin e kërkuar, dhe respektimin prej tyre të afateve të përcaktuara në legjislativonin përkatës;
- Nevoja për ndryshime në amendamentet më të fundit në ligjet "Për Barrët Siguruese" dhe "Për sistemin e pagesave", që, përveç ekzekutimit më të shpejtë të kolateralit cash, sollën edhe shfuqizimin e disa dispozitave të nevojshme për aktivet jo-materiale që mund të përdoren si kolateral nga klientët individë. AAB iu drejtua me shkresa Bankës së Shqipërisë dhe Ministri-

së së Ekonomisë në lidhje me këtë problematikë;

- Komentet dhe sugjerimet për projektligjin "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", duke përcjellë ndër të tjera kërkesën për përfshirjen në Ligj të një liste të shërbimeve financiare dhe bankare të përjashtuara nga TVSH;
- Nevoja për ndryshime në udhëzimin "Për caktimin e tarifave për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat", duke paraqitur komentet e sistemit bankar mbi projekt Udhëzimin e ri të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë;
- Kërkesa për ndryshime, dhe përgatitja e komenteve mbi draftin e paraqitur, të Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka", dhe në vazhdim mbledhja dhe ngritja e problemeve hasur me zbatimin e tij pas hyrjes në fuqi;
- Diskutimi dhe mbledhja e ideve mbi masat e nevojshme rregullatore për tu ndërmarrë kundër publicitetit të keq në media dhe përhapjes së informacioneve spekulative për bankat.

VIII. KOMITETI SISTEMEVE TË PAGESAVE

Çështja kryesore e diskutuar nga Komiteti i Sistemeve të Pagesave, në bashkëpunim edhe me përgjegjësit për TI në banka, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të vitit, ishte projekti i ndërmarrë nga Drejtoria e Tatimeve për një Sistem të ri Informatik të Tatimeve, për deklaratat tatimore dhe pagesat në bankë. Në 6 takime, dhe përmes shumë komunikimeve, Sekretariati i AAB-së u përcollti autoriteteve komentet dhe sugjerimet e bankave që në fazat e para, mbi kushtet teknike të projektit të propozuar, përgjatë implementimit të tij dhe gjatë fazës së testimit, dhe më në fund për përgatitjen

e një Marrëveshjeje të re trepalëshe mes bankave, Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë Tatimore. Sistemi i ri filloi funksionimin në janar 2015.

Një tjetër nismë e mbështetur nga AAB dhe Komiteti i Sistemeve të Pagesave ishte ai i një Ekipi të Bankës Botërore, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, për përgatitjen e një Studimi mbi "Kostot e Pagesave me Pakicë". Bankat dhanë informacion në lidhje me llojet dhe numrin e transaksioneve të kryera, shpenzimet e lidhura me to dhe kanalet e pagesave.

IX. KOMITETI I RI I THESARIT DHE TREGJEVE FINANCIARE

Gjatë vitit 2014, u krijua një komitet i ri teknik nën ombrellën e AAB-së, konkretisht Komiteti i Thesarit dhe Tregjeve Financiare, me anëtarësim të plotë nga 16 bankat anëtare. Kërkesa për një Komitet të tillë erdhi nga drejtuesit e departamenteve të thesarit në banka, bazuar në domosdoshmërinë për të diskutuar mbi çështje që lidhen me zhvillimin e tregjeve ndërbankare, produktet dhe tendencat e reja, si dhe për të adresuar, me një qasje

të unifikuar, çështje të natyrës rregullatore dhe marrëdhëniet me autoritetet. Kryetari i parë i Komitetit, zgjedhur në mbledhjen e parë, është Z. Erion Taçe, nga Societe Generale Albania.

Komiteti përcaktoi disa objektiva për vitin 2015 dhe iniciativa të ndryshme që duhet të ndërmerren për të zhvilluar tregun e parasë dhe financiar në vend dhe përmirësuar tregun ndërbankar.

II TAKIME TË TJERA

I. ME BANKËN E SHQIPËRISË

- **Ndryshime Rregulloresh** - Drejtuesit e Departamenteve të Rrezikut të Kredisë në banka dhe përfaqësues të Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, u takuan në ambientet e AAB-së në shkurt 2014 për të diskutuar ndryshimet e propozuara në Rregulloret "Për administrimin e rrezikut të kredisë" dhe "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave". Ky takim u pasua nga një Forum i organizuar nga Banka e Shqipërisë, ku Guvernatori informoi drejtorët e bankave mbi masat e marra për ruajtjen e stabilitetit financiar, rritjen e kreditimit, dhe uljen e kredive me probleme. Si në nivel teknik edhe në atë drejtues, përfaqësuesit të bankave shprehën qëndrimet dhe pritshmëritë e tyre, veçanërisht lidhur me detyrimin për fshirjen e kredive të këqija pas një periudhe të caktuar.
- **BASEL II dhe paketa raportimit (COREP)** - Mbledhjet e grupit të punës krijuar me përfaqësues të bankave dhe Bankës së Shqipërisë për zbatimin e BASEL II, vijuan edhe gjatë vitit 2014. Në përfundim të diskutimeve, përfaqësuesit e bankave formuluan një sërë çështjesh e pyetjesh në lidhje me Rregulloren mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit, si dhe me tabelat e raportimit (CoRep). Sekretariati i AAB-së ia dërgoi të gjitha pyetjet e mbledhura nga bankat Bankës së Shqipërisë, e cila do të përgatisë një përmbledhje përgjigjesh që do të publikojë në faqen e saj zyrtare, në formatin e një udhëzuesi.
- **Regjistri i Kredive** - Përfaqësues të Departamenteve të Rrezikut Operacional dhe Kredisë në banka u takuan me përfaqësues të Departamenteve të Mbikëqyrjes dhe TI në Bankën e Shqipërisë, për të diskutuar mbi përmirësimet e mundshme dhe të nevojshme në Regjistrin e Kredive. Përfaqësuesit e bankave listuan kërkesat që lindin në procesin e tyre të punës, duke theksuar nevojën për më shumë të dhëna, të domosdoshme për kryerjen e vlerësimeve.
- **Për kreditë me probleme** - Drejtues të nivelit të lartë të bankave u takuan me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë për një iniciativë për uljen e kredive me probleme, në bashkëpunim me Projektin FinSAC të Bankës Botërore dhe ADAstra. Ky projekt parashikonte bashkëpunimin e bankave, nën drejtimin e Bankës së Shqipërisë dhe ekspertëve të ADAstra-s, për analizimin dhe trajtimin e kredive me probleme të një grupi huamarrësish të mëdhenj, nëpërmjet ristrukturimeve të mundshme apo mjeteve të tjera të përbashkëta. Projekti vijoi gjatë gjithë vitit me disa raste suksesi.

II. ME QEVERINË / AUTORITETET

▪ Kryeministri dhe KEK

Në janar 2014 disa prej drejtuesve të bankave morën pjesë në një takim të organizuar në Këshillin e Ministrave, ku Kryeministri prezantoi zyrtarisht organizimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar (KEK), si një organ konsultimi dhe këshillimi, mes Qeverisë dhe komunitetit të biznesit. Ish Kryetari i AAB-së, Z. Pencabligil, pati mun-

dësinë të shprehte shqetësimet e sistemit bankar në shtatë nga mbledhjet e Këshillit Ekonomik Kombëtar që u organizuan gjatë vitit, me praninë e Kryeministrit, Ministrave, Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, sipërmarrësve, ekspertëve nga FMN dhe Banka Botërore, si dhe ekspertëve të tjerë të huaj që asistojnë qeverinë shqiptare.

▪ Ministria e Financave

Ministri i Financave, Z. Cani, u takua në shkurt 2014 me drejtorët e bankave në një tryezë të rrumbullakët të organizuar në ambientet e Ministrisë. Ai informoi mbi nismat e reja të Ministrisë, sidomos mbi aksionin për shlyerjen e pagesave të vonuara ndaj kompanive private.

▪ Ministri i Energjisë dhe Industrisë

Në nëntor 2014, KEK në bashkëpunim me disa shoqata dhe Dhoma Tregtie, me pjesëmarrjen e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe Zv. Ministrit të Financave, organizoi një tryezë të rrumbullakët për çështjen e detyrimeve të papaguara që KESH ka ndaj prodhuesve privatë, të cilët, për rrjedhim, janë në vonesë në pagesat ndaj shumë prej bankave.

Në vijim, AAB në bashkëpunim me KEK, organizoi një tryezë të rrumbullakët me Drejtorët e bankave anëtare, Ministrin e Energjisë, dhe përfaqësues

Drejtorët e bankave përcollën shqetësimet e sistemit bankar lidhur me faktorët ekonomikë, por sidomos lidhur me zbatimin e dobët të ligjit dhe precedentët negativë të praktikave gjyqësore për ekzekutimin e kolateraleve apo çështje të tjera.

të lartë të KESH dhe OSHEE, ku pjesëmarrësit diskutuan mbi ndryshimet e fundit dhe masat e ndërmarra nga Ministria e Energjisë në lidhje me prodhuesit privatë të energjisë, si dhe mbi shqetësimet e bankave si huadhënës të tyre. Fokusi kryesor i takimit ishte gjetja e burimeve të mundshme për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për KESH për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj prodhuesve, si dhe përfshirjen e mundshme të bankave.



▪ Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)

AAB organizoi 3 tryeza të rrumbullakëta me anëtarët e Komitetit të Përputhshmërisë së AAB, përfaqësues të DPPPP, si dhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë në mars, korrik dhe dhjetor 2014. Tryeza e parë u fokusua në përmirësimin e raportimit të aktiviteteve të dyshimta, rritjen e kujdesit të duhur nga bankat, si dhe mbi shqetësime të përbashkëta dhe tipologji të reja të pastrimit të parave të hasura nga bankat dhe autoritetet. Në takimet vijuese theksi u vu në

masat parandaluese që duhet të merren nga bankat; cilësia analizimit dhe raportimit të rasteve të dyshimta të raportuara prej tyre; nevoja për trajnim të punonjësve nëpër degë; dhe nevoja për reduktimin e periudhës së bllokimit të llogarive të klientëve nga 48 orë në 24 orë. Në këto takime, pjesëmarrësit sollën raste praktike dhe diskutuan mbi probleme të veçanta teknike të hasura gjatë raportimit të bankave dhe për mënyrën më të mirë për ti trajtuar ato në të ardhmen.



▪ Këshilli Tatimor

Sekretarja e Përgjithshme e AAB-së mori pjesë në 3 mbledhjet e Këshillit Tatimor të organizuara gjatë vitit, ku përcolli komentet dhe opinionet e bankave në lidhje me ndryshimet në legjislacionin fiskal, edhe pse ato nuk janë marrë gjithmonë në konsideratë. Gjatë vitit, Këshilli diskutoi kryesisht

mbi hartimin e Ligjit për TVSH-në dhe Udhëzimin përkatës, si dhe mbi ndryshimet në pjesë të tjera të legjislacionit fiskal. Këshilli diskutoi gjithashtu për implementimin e sistemit të ri informatik për tatimet.

▪ Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Përfaqësuesit e bankave kanë ngritur vazhdimisht çështjen e numrit gjithnjë e në rritje të urdhrave të bllokimit dhe kërkesave për informacion mbi llogaritë e klientëve, nga disa institucione (shtetërore). Pas fluksit më të fundit të papërbalueshëm të kërkesave nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Sekretariati i AAB-së i përcolli këto shqetësime në një shkresë zyrtare, duke kërkuar shpërndarjen e fluksit përgjatë vitit, në mënyrë

që bankat të kenë mundësi të menaxhojnë ngarkesën operacionale për trajtimin e këtyre kërkesa/urdhrave, duke pasur parasysh se ky nuk është aktiviteti kryesor i bankave.

Në vijim, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim të përfaqësuesve të bankave me Kryeinspektorin e ILDKPKI-së. Në takim u arrit një marrëveshje për shkëmbimin elektronik të kërkesave dhe raportimit, për të lehtësuar procedurat e bankave.

III. ME INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE

▪ Banka Botërore

Kryetari dhe Sekretarja e Përgjithshme e AAB-së takuan dy herë gjatë vitit, si dhe mbajtën komunikim të vazhdueshëm, me ekipin e Bankës Botërore, në mision në Tiranë për përgatitjen e Huasë në mbështetje të Politikave Zhvillimore për

Modernizimin e Sektorit Financiar Shqiptar (DPL). Objektivi i misionit ishte hulumtimi i zhvillimeve në sektorin bankar, për finalizimin e diskutimeve me autoritetet mbi reformat për tu ndërmarrë në sektorin financiar të mbështetura nga kjo DPL.

▪ IFC

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë nisi një projekt të ri për "Shlyerjen e Borxhit" që synon mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, sektorit bankar dhe komunitetit të biznesit për rritjen e rikuperimit të kredive, ndër të tjera, edhe nëpërmjet

përmirësimit të likuidimit efektiv. Në këtë kuadër ekspertët e IFC u takuan me përfaqësues të bankave, si aktorë të rëndësishëm në këtë drejtim, duke u fokusuar në zhvillimin e kornizës ligjore për të përmirësuar procedurat e falimentimit.

▪ BQE

Z. Yves Mersch, anëtar i Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane, me rastin e lançimit të një projekti bashkëpunimi teknik me Bankën e Shqipërisë, u takua edhe me Bordin Drejtues të AAB-së. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i

pikëpamjeve mbi gjendjen e sektorit bankar në Shqipëri dhe Eurozonë, sfidat me të cilat bankat po përballen, si dhe perspektivat për thellimin e mëtejshëm financiar dhe ringjalljen e kreditimit.

III EDUKIMI FINANCIAR

I. JAVA E PARASË

AAB bashkëpunoi për të dytin vit me Bankën e Shqipërisë për organizimin e disa veprimtarive në kuadrin e Javës Globale të Parasë. Veprimtaritë u çelën më 13 Mars 2014 me një aktivitet të përbashkët, ku Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi me qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për edukimin financiar të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazeve, si dhe studentëve e universiteteve, në fushat e ekonomisë, financave e bankave.

Gjatë javës, për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj rëndësisë së edukimit financiar që në moshë të vogël, u zhvilluan këto aktivitete:

10-13 mars - Gjatë 4 ditëve, nxënësve të shkollave të mesme që ndjekin lëndën “Financat personale në duart tuaja”, iu dha mundësia të vizitojnë degë të bankave tregtare në Tiranë dhe në rrethe, ku punonjësit e degëve u shpjeguan mbi aktivitetet bankare. Nxënësit që vizituan bankat në Dibër, Peshkopi, Lushnje dhe një degë banke në Tiranë u takuan edhe me Drejtorët e Përgjithshëm të bankave, me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë dhe me Kryetarin e AAB-së.



10-17 mars - Nxënësit e klasave I-III të shkollave fillore morën pjesë në një konkurs vizatimesh. Dhjetë vizatimet me më tepër “pëlqime” në facebook morën dhurata simbolike dhe përfituan depozita bankare me shuma 10,000 lekë, sponsorizuar nga Raiffeisen Bank.





10-17 Mars – Teatri i Kukullave në Tiranë, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, vuri në skenë shfaqjen për fëmijë: “Çufo dhe Tipi - Një aventurë me verdhushka”, 8 shfaqje të të cilës, të ndjekura nga mbi 1,000 nxënës të shkollave 9-vjeçare, u sponsorizuan nga Banka Kombëtare Tregtare.



17 mars – AAB organizoi leksione të hapura me temë: “Banka dhe Paraja” në Universitetin Jopublik “Illyria” dhe në Shkollën Teknike Ekonomike në Tiranë.



ii. PROJEKTE TË TJERA

▪ Junior Achievement

“Drejtues për një ditë” ishte një iniciativë në kontekstin e programit të Junior Achievement në Shqipëri - një program edukativ i dedikuar për t’u siguruar njohuri financiare të rinjve dhe për t’i përgatitur ata të hyjnë në tregjet e punës. Projekti në fjalë u mundëson nxënësve të shkollave të mesme të mësojnë nga drejtorët ekzekutivë, përgjatë një dite pune. Sekretarja e Përgjithshme e AAB-së mirëpriti një nxënëse nga Elbasani në ambientet e AAB-së, që e shoqëroi në aktivitetet gjatë ditës.



▪ Video informative mbi produktet dhe shërbimet bankare

AAB ndërmori një projekt për publikimin e një serie videosh informative, të quajtur “Banka ime”. Dy videot e para të përgatitura e shfaqura gjatë 2014 ishin “Kartat Bankare” me pjesëmarrjen e z. Erion Maxhari, Drejtues i Kartave tek FIBank dhe zv/Kryetar i Komitetit të Kartave të AAB-së, dhe “Metodat e pagesave”, me pjesëmarrjen e zj. Najada Xhaxha, Drejtuese e Pagesave tek Tirana Bank dhe Kryetare e Komitetit të AAB-së për Sistemet e Pagesave. Videot përgatiten me mbështetjen e një gazetari ekonomik që drejton intervistat me specialistët e bankave. Të dy videot u publikuan në faqen e internetit të AAB-së si dhe rrjetet sociale (facebook dhe youtube)



▪ Broshura “Kredia Konsumatore”

AAB përgatiti dhe shpërndau tek degët e bankave anëtare broshurën informative “Kredia Konsumatore”. Ky projekt u zbatua nga Sekretariati në bashkëpunim me një grup pune të krijuar nga përfaqësues të 4 bankave të cilët përgatitën përmbajtjen e broshurës. AAB bashkëpunoi edhe me Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit, për të përmbushur kërkesat e saj në lidhje me transparencën për këtë produkt. Broshura jep informacion dhe mbështetje të mëtejshme për klientët bankarë të interesuar për kredi konsumatore.



▪ Ekspozimi i Broshurës për Kartat në qendër tregtare

Sekretariat i AAB-së bashkëpunoi me rrjetin Neptun për të ekspozuar në mjediset e Qendrës Tregtare TEG broshurën mbi “Kartat Bankare”, publikuar dhe promovuar nga AAB në forumin e tretë kombëtar të kartave. Ky projekt synoi të informojë zotëruesit aktualë dhe të mundshëm të kartave bankare mbi përdorimin, përfitimet dhe kushtet e tyre.



IV TRAJNIME DHE SEMINARE

Sekretariati i AAB-së bashkëpunoi gjatë vitit me **më shumë se 10 partnerë**, në organizimin e **15 kurseve të trajnimit**, **3 seminareve** dhe **3 Forumeve**. Në total, **233 punonjës të bankave** anëtare morën pjesë në trajnimet dhe seminarët e organizuara nga AAB gjatë vitit 2014, si edhe **62 gjyqtarë** u trajnuan në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.

i. FORUME & SEMINARE

▪ Forumi Kombëtar i Kartave

16 Maj 2014 - AAB dhe Komiteti i saj i Kartave organizuan Forumin e katërt Kombëtar të Kartave me temë "Biznesi i kartave - Zhvillime dhe risi". Këtë vit forumi u fokusua më shumë në zhvillimet në industrinë dhe biznesin e kartave. Përfaqësues nga bankat tregtare në Shqipëri e Kosovë, nga

Banka e Shqipërisë, nga Visa, Master Card dhe PayLink, përfaqësues të shoqërive lokale e ndër-kombëtare që ofrojnë shërbime teknologjike në fushën e pagesave elektronike, si dhe përfaqësues të kompanive të shërbimeve utilitare morën pjesë aktivisht në Forum.



▪ Forumi i tretë Kombëtar i tretë për Sigurinë në Banka

28 Maj 2014 - AAB bashkëpunoi për herë të parë me Shoqatën e Bankave të Kosovës për organizimin e përbashkët të Forumit të tretë Kombëtar për "Sigurinë në banka", në Prizren, Kosovë. Këtë vit, Forumi mbledhi ekspertë nga dy fusha të sigurisë bankare: ajo fizike dhe siguria e informacionit. Një

theks i veçantë u vu mbi zhvillimet e reja në fushën e sigurisë bankare, dhe veçanërisht në bashkëpunimin ndërmjet strukturave të sigurisë të bankave tregtare dhe institucioneve mbikëqyrëse dhe qeveritare e partnerëve të tjerë.



▪ Forumi i Biznesit SWIFT

17 Shtator 2014 - AAB në bashkëpunim me SWIFT Austria dhe CIS, organizuan Forumin e Parë të Biznesit - SWIFT Albania 2014, me temë: "20 vjet në Shqipëri, 20 vjet partneritet". Forumi u ndoq nga përfaqësues të bankave tregtare në Shqipëri, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, institucioneve financiare



jobanka, kompanive të shërbimeve utilitare, etj. Pjesëmarrësit në forum theksuan përmes prezantimeve përfitimet reciproke të sistemit bankar dhe SWIFT gjatë këtyre viteve të bashkëpunimit, sfidat e reja dhe mundësitë për të ardhmen. Gjithashtu, përfaqësuesit e SWIFT prezantuan zgjidhjet që kompania ofron për të gjithë partnerët.



▪ Seminar mbi Qeverisjen e Korporatave

26 mars 2014 - Instituti i Qeverisjes së Korporatave Shqipëri (CGIA) në bashkëpunim me Projektin e Qeverisjes së Korporatave të IFC, organizuan një seminar për punonjësit e Përputhshmërisë të

bankave anëtare ku ata përfituan nga ekspertiza kombëtare e ndërkombëtare e trajnuesve dhe ndanë përvojat mbi funksionin e përputhshmërisë dhe menaxhimit efektiv të rrezikut.

▪ Takim diskutimi mbi Bazel II

22-23 tetor 2014 - AAB, në bashkëpunim me ekspertët e Moody's Analytics (UK), organizoi tre seminare mbi Bazel II, me pjesëmarrjen e bankave tregtare dhe përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë. Seminari u përqendrua në praktikat më të mira për zbatimin e Bazel II/III dhe u ndoq nga 45 pjesëmarrës nga bankat anëtare.

▪ Manaxhimi i Shitjes së Suksesshme të Kartave

3-4 dhjetor 2014 - AAB organizoi 2 seminare, të ofruar falas nga VISA për bankat emetuese të kartave VISA, me qëllim mbështetjen për bankat në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme, për të gjetur mënyrat më efikase për shitjen e produkteve të kartës VISA. Seminarët u ndoqën nga 30 pjesëmarrës.



ii. TRAJNIMET

AAB bashkëpunoi me partnerë të ndryshëm për të plotësuar programin e trajnimeve të ofruara për bankat anëtare gjatë vitit 2014.

Në bashkëpunim me ICC Albania:

▪ 16-17 prill 2014 - Trajnim mbi Garancitë Bankare

ICC Albania, me mbështetjen e AAB-së dhe Raiffeisen Bank, organizoi një kurs dyditor mbi garancitë bankare. Trajnimi u drejtua nga z. Andrea Hauptmann, anëtar i ICC Austria dhe delegat në Komisionin e Bankingut të ICC. 14 pjesëmarrës nga bankat, dhe 11 të tjerë nga firma ligjore dhe shoqëri të tjera morën pjesë në trajnim.



▪ 15-16 shtator 2014 - seminare mbi "Rregullat e financimit të tregtisë" dhe "Rregullat INCOTERMS 2010"

Seminari me temë "Rregullat e financimit të tregtisë" ishte praktik me fokus pagesat ndërkombëtare dhe instrumentet e financimit, e veçanërisht zhvillimet në zonat e tregtisë me llogari të hapura.

"Rregullat INCOTERMS 2010" pati për qëllim përcaktimin e përgjegjësive të blerësve dhe shitësve, në lidhje me dërgesat e mallrave sipas kontratës së shitjes. Të dy seminarët u drejtuan nga lektori Andre Pavel, Sekretar i Komisionit Bankar të ICC për Republikën Çeke dhe u ndoqën nga 23 pjesëmarrës nga 7 banka anëtare.



▪ 17 shtator 2014 - Seminar "Mashtrimet tregtare në një klimë të pasigurt ekonomike"

Seminari u organizua në bashkëpunim me Shërbimet e Kriminologjisë të ICC në Londër dhe u drejtua nga Michael Howlett, zv/Drejtor i IMB dhe Drejtor i Shërbimeve të Kriminologjisë të ICC dhe Dave Cuckney, Manaxher i IMB. Seminari u ndoq nga 16 pjesëmarrës.



PARTNERITETI ME ATTF

AAB është partneri i vetëm zyrtar për Shqipërinë i ATTF (Financial Technology Transfer Agency) Luksemburg, që prej shtatorit 2014.

Gjatë vitit 2014, tetë punonjës të bankave anëtare morën pjesë në trajnimet e ofruara nga ATTF me temat: Financimi i Ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla (6-14 tetor 2014); Parandalimi i pastrimit të parave, Niveli II & Kurs përgatitor për provimet CAMS® (20-27 tetor 2014); dhe Seminari ndërkombëtar CAMBOC mbi tregjet kapitale dhe operacionet back-office (24-28 nëntor 2014).

Në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm (AIIA)

▪ 7-8 maj 2014 - Trajnim "Rreziku, kontrolli dhe qeverisja"

Trajnimi prezantoi praktikat më të mira në fushën e kontrollit, dhe ngritjen e vlerës së investimeve të shoqërisë në kontrollet e brendshme, në mbështetje të qëllimeve dhe objektivave të biznesit. Trajnimi u frekuentua nga 10 pjesëmarrës nga 8 banka anëtare.



▪ 9-10 maj 2014 - Trajnim "Përgatitje për provimin CIA (Pjesa 1)"

Anëtarët e Komitetit të AAB-së së Auditorëve të Brendshëm morën pjesë në trajnimin CIA Pjesa 1: Bazat e Auditit të Brendshëm, ofruar në partneritet nga JP Consulting dhe AIIA. Certifikimi i Auditorëve të Brendshëm® (CIA®) është standardi më i lartë të cilin auditorët e brendshëm profesionistë tregojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre.



▪ 15-16 shtator 2014 - Trajnim "TI për joprofesionistët e TI"

Trajimi u projektua për auditorë të brendshëm në sektorin e financës dhe Teknologjisë së Informacionit, si dhe punonjës të departamenteve të sigurisë së informacionit. Kursi intensiv dyditor përmbledhi konceptet e teknologjisë së informacionit, të nevojshme për të kuptuar shqetësimet e auditit në mjedisin e TI-së, dhe u ndoq nga 15 pjesëmarrës.



▪ 24-25 nëntor 2014 - Trajnim mbi Teknikat e Zbulimit të Mashtimit

Gjatë trajnimit u prezantuan praktikat aktuale më të mira, të mbështetura në raste studimore, të ndodhura në vendet e rajonit, për identifikimin e zonave më të mundshme për alarm sa më parë, që të mund të minimizohen dëmet. Trajnimi u ndoq nga 22 përfaqësues të bankave anëtare.



Në bashkëpunim me WIFI Albania

▪ 16-17 prill 2014 - Trajnimi: "Përsosmëri e teknikave në Shitje"

Kursi u projektua për menaxherë shitjesh, të cilët duan të përsosin teknikat e planifikimit të shitjeve, të ndërtojnë aftësitë drejtuese, të vendimarrjes, motivimit, komunikimit dhe këshillimit. Trajnimi u drejtua nga trajneri ndërkombëtar i suksesshëm Eric Molin dhe u ndoq nga 9 menaxherë nga 4 banka anëtare.



▪ 29-30 maj 2014 - Trajnimi "Komunikimi i Marketingut të Integruar"

Trajnimi synonte aftësimin e pjesëmarrësve të zgjedhin mjetet e duhura promocionale, në përputhje me strategjinë e marketingut të shoqërisë së tyre. Trajnimi u frekuentua nga 9 pjesëmarrës të bankave anëtare.



▪ 18-19 shtator, 2014 - Menaxhimi Strategjik i Burimeve Njerëzore

Trajnimi kishte për qëllim pajisjen e pjesëmarrësve me aftësi personale dhe njohuri profesionale për një praktikues të suksesshëm të Burimeve Njerëzore, duke bërë të mundur përçimin e njohurive dhe eksperiencës në vendin e punës. Trajnimi u ndoq nga 8 pjesëmarrës nga 6 banka anëtare.



Bashkëpunim me partnerë të tjerë

▪ 10-11 prill 2014 - Trajnim "Prezantimi Dinamik"

AAB bashkëpunoi me Qendrën Linkoln në Tiranë në organizimin e një trajnimi dyditor me temë: "Prezantimi Dinamik", që u fokusua në strukturën dhe mënyrën e prezantimit, përdorimin e mjeteve vizive dhe transmetimit të audienca. Trajnimi u ndoq nga 11 pjesëmarrës nga bankat anëtare.



▪ 17 prill 2014 - Trajnimi me temë: “Shitje e Drejtpërdrejtë”

AAB në bashkëpunim me “EP & partners consultancy” organizoi një seminar interaktiv mbi kanalet e shitjes së drejtpërdrejtë me qëllim ngritjen e aftësive të pjesëmarrësve për të qenë më të suksesshëm me to e për të strukturuar më mirë forcat e shitjes. Në të morën pjesë 13 punonjës të bankave anëtare.



▪ 21-22 prill 2014 - Trajnimi mbi Aftësitë Drejtuese

Për herë të tretë AAB solli në Tiranë trajnuesin me eksperiencë ndërkombëtare, Paul Gauci, i cili drejtoi një trajnim dyditor mbi aftësitë drejtuese për menaxherë, supervisorë dhe drejtues grupi. Trajnimi u ndoq nga 10 përfaqësues të bankave anëtare.



Në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës

9-10 qershor 2014 – Trajnimi “Titujt Ekzekutivë në procedurën civile dhe titujt ekzekutivë në kuptimin e ligjit të posaçëm”. Në të u diskutua rreth: kundërshtimit të veprimeve përmbartimore dhe pavlefshmëria e titullit ekzekutiv; standardeve sipas nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, lidhur me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm; akteve të dhënies së huas bankare si Titull Ekzekutiv dhe nocioni i Urdhrit të Ekzekutimit i lidhur me të; problematikës ligjore të ndeshur gjatë praktikës gjyqësore të lëshimit dhe kundërshtimit të Urdhrit të Ekzekutimit. Në trajnim morën pjesë 29 gjykatës nga 12 rrethe.



25-26 qershor 2014 - Trajnimi “Masat e sigurimit civil të padisë”, ku u diskutua: trajtimi integral i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm; praktika gjyqësore dhe ajo unifikuese, lidhur me masat e sigurimit të padisë; aplikimi për rastet e procedurave përmbartimore për ekzekutimin e kontratave të huave bankare. Në trajnim morën pjesë 31 gjykatës dhe 2 asistentë të Gjykatës së Apelit të Tiranës.



Botimi i 10-të, 11-të, 12-të dhe 13-të i Revistës BANKIERI

Sekretariati i AAB-së shpërndau në Janar, Prill, Korrik dhe Tetor 2014 katër botime të reja të revistës BANKIERI, për të gjithë komunitetin bankar, institucionet shtetërore, Universitetet publike e private, organizata ndërkombëtare në Shqipëri e jashtë saj, media dhe shoqata të tjera bankare në rajon. Versionet Shqip dhe Anglisht të revistës janë të aksesueshme nga publiku në faqen e internetit të AAB-së.

Me rastin e mbushjes së tre vjetëve nga botimi i numrit të parë të revistës Bankieri në Tetor, Kryeredaktori i saj, z. Elvin Meka shkruajti një artikull të veçantë që u botua nga disa gazeta të përditshme si dhe media në internet.

Statistika

AAB publikoi në faqen e internetit të dhënat financiare të paaudituar të treguesve kryesorë të sistemit bankar sipas standardeve IFRS, si dhe të dhëna të agreguara për të gjithë sistemin. Statistikat tremujore u shoqëruan edhe me njoftime për shtyp të shpërndara në media.

Lajme Mujore

Sekretariati ka informuar të gjithë bankierët, në nivel manaxherial e teknik, nëpërmjet një njoftimi mujor, mbi të gjitha aktivitetet e AAB-së.

BANKAT ANËTARE – FAKTE DHE SHIFRA

Banka	Struktura e Aksionarëve	Vendi i origjinës	Aktivet	Kreditë	Investime me Letra me Vlerë të Qeverisë
 ALPHA BANK	Alpha Bank AE (100%)	Greqi	563,719	255,414	126,546
 BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Finansal Hizmetler A.S. (100%)	Turqi	2,263,340	756,690	1,003,499
 CREDINS bank	Individë dhe Unioni SHKK (78%)	Shqipëri	932,517	569,462	110,276
	B.F.S.E Holding (19.25%)	Hollandë			
	SIFEM AG (2.75%)	Zvicër			
 CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT E SHQIPËRISE	Al-Kharafi Group (100%)	Kuvajt	13,937	1,994	734
 CRÉDIT AGRICOLE	IUB Holding SAS (100 %)	Francë	191,332	126,048	8,187
 Fibank First Investment Bank	Fibank AD (100%)	Bullgari	112,978	41,244	36,475
 INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK	ICB Financial Holding Group (100%)	Zvicër	63,724	23,252	25,357
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A. (100%)	Itali	1,056,304	336,722	411,831
 NBG Bank	NBG Group S.A. (100%)	Greqi	316,312	196,200	60,398
 ProCredit Bank	ProCredit Holding AG & Co. KGaA (100%)	Gjermani	262,626	154,809	23,562
 Raiffeisen BANK	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH (100%)	Austri	1,964,285	895,529	613,489
 SOCIETE GENERALE ALBANIA	Societe Generale (88.64%)	Francë	510,399	278,692	146,387
	Aksionerë të tjerë (11.36%)	Shqipëri			
 TIRANA BANK	Piraeus Bank (98.83%)	Greqi	727,435	330,384	222,292
	Ioannis Tzivelis (1.17%)				
 UNIONBANK	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k (85.66%)	Shqipëri	255,633	112,545	87,669
	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) (10.62%)	UK			
	Individë (3.72%)	Shqipëri			
 UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Islamic Development Bank (86.7%)	Arabia Saudite	44,687	11,418	6,819
	Ithmaar Bank (4.63%)	Bahrain			
	Dallah Albaraka Holding Co. (2.32%)	Bahrain			
	Business Focus SDN BHD (1.47%)	Malajzi			
	Aksionerë të tjerë (4.89%)	Arabia Saudite			
 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA	Veneto Banca Scpa (100%)	Itali	192,018	123,230	15,285

Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 31.12.2014, në mijë EUR (1 EUR = 140.14 ALL)

Kapitalet e veta	Depozita	Fitimi Neto	Nr. degësh	Nr. punonjë-sish	Nr. ATM	Nr. karta të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking	Mobile Banking	E-commerce
78,070	464,761	2,753	40	405	57	61,346	53,897	7,449	1,254	PO	PO	JO
202,795	1,760,287	36,122	88	1,287	91	140,786	115,673	25,113	2,046	PO	PO	PO
72,602	802,596	2,748	49	654	58	90,110	86,773	3,337	418	PO	PO	PO
7,823	4,088	586	2	28	-	-	-	-	-	JO	JO	JO
28,518	147,219	(4,037)	20	248	32	12,616	11,818	798	-	PO	JO	JO
9,849	99,814	677	9	122	30	30,955	27,835	3,120	-	PO	JO	JO
11,476	46,289	269	6	85	6	2,171	2,171	-	-	JO	JO	JO
137,603	865,418	14,669	32	566	52	74,872	74,872	-	657	PO	PO	JO
57,666	235,979	1,057	27	284	36	26,048	25,538	510	-	JO	JO	JO
34,563	211,891	1,196	25	362	57	40,905	39,843	1,062	384	PO	JO	JO
208,710	1,668,826	33,707	90	1,403	193	215,385	189,670	25,715	1,462	PO	PO	PO
58,391	420,291	3,404	42	400	62	31,173	31,173	-	-	PO	PO	JO
127,636	557,181	(5,410)	47	448	79	87,252	82,763	4,489	302	PO	PO	JO
21,248	213,653	2,248	28	327	39	38,472	36,598	1,874	-	PO	PO	JO
10,484	33,888	177	6	72	-	-	-	-	-	JO	JO	JO
29,059	156,484	(3,687)	15	134	16	8,310	8,149	161	16	PO	JO	JO

A close-up, high-angle photograph of a typewriter. The focus is on a sheet of paper with the words "Balance Sheet" printed in a bold, black, serif font. The paper is slightly crumpled and positioned over the typewriter's keyboard. The keyboard keys are visible in the foreground, showing their metallic and plastic components. The lighting is dramatic, highlighting the textures of the paper and the mechanical parts of the typewriter. The background is blurred, emphasizing the text on the paper.

Balance Sheet

PASQYRAT FINANCIARE TË AAB-së
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2014

Në LEK	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
AKTIVET			
Arka dhe banka	4	14,571,268	7,042,838
Shpenzime të parapaguara	5	1,065,692	698,843
Llogari të arkëtueshme		-	302,554
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		15,636,960	8,044,234
Aktivet Afatgjata			
Aktivet e qëndrueshme, neto	6	810,693	854,513
Totali i Aktiveve Afatgjata		810,693	854,513
TOTALI I AKTIVEVE		16,447,653	8,898,747
DETYRIMET			
Detyrime ndaj Bankave	7	-	-
Llogari të pagueshme	8	626,645	432,425
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		626,645	432,425
Aktivet Neto		15,821,008	8,466,322
TOTALI I DETYRIMEVE		16,447,653	8,898,747

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE MË 31 DHJETOR 2014

Në LEK	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Të ardhurat	9		
Kuotat e anëtarësisë		33,000,000	33,001,000
Të ardhura të tjera		887,804	6,576,113
Totali i të Ardhurave		33,887,804	39,577,113
Shpenzimet			
Amortizimi	6	(201,379)	(249,130)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrimit	10	(26,332,051)	(39,563,458)
Humbje nga këmbimet	11	313	(39,013)
Totali i Shpenzimeve		(26,533,117)	(39,851,601)
Teprica/(Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		7,354,686	(274,488)
Aktivet Neto në fillim të vitit		8,466,322	8,740,810
Aktivet Neto në fund të vitit		15,821,008	8,466,322

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARAVE MË 31 DHJETOR 2014

Në LEK	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
<i>Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit</i>			
Teprica/(Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		7,354,686	(274,488)
Rregullime për :			
Amortizimin	6	201,379	249,130
Pagesa për shpenzimet e parapaguara	5	(86,689)	(124,422)
Llogari të arkëtueshme		22,394	(9,304)
Pagesa për llogaritë e pagueshme	7	194,220	(364,493)
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit		7,685,990	(523,577)
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</i>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	6	(157,560)	(80,820)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		(157,560)	(80,820)
Rritja/(Rënia) neto e mjeteve monetare		7,528,430	(604,338)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4	7,042,838	7,647,176
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	4	14,571,268	7,042,838

Pasqyra e rrjedhës së Parave duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar në datë 30.03.2015 dhe nënshkruar nga:



Endrita XHAFERAJ
Sekretare e Përgjithshme
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Brunilda JAKOVI
Drejtoare e Operacioneve
NBG BANK ALBANIA

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Ap. 9/3, Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përqipet të promovojë standardet më të fundit bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank Albania, Banka Credit Agricole Shqipëri, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka e Kreditit e Shqipërisë, Banka Kombëtare Tregtare, Banka NBG Albania, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Credins Bank, Fibank Shqipëri, Intesa SanPaolo Bank Albania, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank Shqipëri, Societe Generale Albania, Tirana Bank, Union Bank, dhe Veneto Banka.

2. Baza e Përgatitjes

Librat dhe regjistrimet kontabël të AAB mbahen sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet kur ndodhin.

3.2 Aktivitet e Qëndrueshme

Aktivitet e qëndrueshme mbahen me kosto, minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi kryhet sipas metodës së vlerës së mbetur, duke shpërndarë koston e pasurisë dhe pajisjeve, përgjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit të tyre. Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes, me normat respektive prej:

	Në %
Mobiliet	20
Pajisjet elektronike	25

3.3. Konvertimi nga Monedha e Huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un (ALL). Të gjithë kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në Lek (ALL). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit.

3.4 Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe si e tillë është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Arka	29,546	398,294
Banka	14,541,722	6,644,544
Totali	14,571,268	7,042,838

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Banka përbëhet nga sa më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Llogari në LEK, pranë BKT	11,867,421	5,188,420
Llogari në LEK, pranë Union Bank	1,585,337	618,247
Llogari në EUR, pranë BKT	317,418	772,917
Llogari në LEK, pranë Veneto Banka	771,546	64,960
Totali	14,541,722	6,644,544

5. Shpenzime të Parapaguara

Shpenzimet e parapaguara përbëhen kryesisht nga: pagesat e anëtarësimit të Shoqatës pranë BACEE për shumën 604,240 Lekë; parapagime për kontrata një vjeçare për mirëmbajtje dhe hostim interneti dhe domain-esh (si për faqen zyrtare të internetit të Shoqatës, ashtu edhe për faqen e ankandeve); si dhe parapagimi i sigurimit shëndetësor pranë Sigal të punonjësve të Shoqatës), si më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Kuotë Anëtarësimi e parapaguar BACEE	604,240	531,138
Abonim ABCOM (internet)	11,060	11,074
Hostim dhe mirëmbajtje Domain	23,232	8,431
Sigurim Shëndetësor SIGAL UNIQA GROUP	147,000	148,200
Garanci për Qira	280,160	-
Totali	1,065,692	698,843

6. Aktivitet e Qëndrueshme

Aktivitet e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

Në LEK	Mobilie / Orendi	Pajisje Elektronike	Totali
Kosto			
Në 31 Dhjetor 2013	1,975,068	1,023,246	2,998,314
Shtesat gjatë vitit 2014	18,890	138,670	157,560
Pakësimet gjatë 2014			
Në 31 Dhjetor 2014	1,993,958	1,161,916	3,155,874
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 Dhjetor 2013	1,377,165	766,636	2,143,801
Amortizimi gjatë vitit 2014	107,088	94,292	201,379
Pakësimet gjatë 2014			
Në 31 Dhjetor 2014	1,484,253	860,928	2,345,180
Vlera Neto e Librit			
Në 31 Dhjetor 2013	597,903	256,610	854,513
Në 31 Dhjetor 2014	509,705	300,988	810,693

NOTES ON THE FINANCIAL STATEMENTS

7. Detyrime ndaj Bankave

Viti 2014 është mbyllur pa detyrime ndaj bankave.

8. Llogari të Pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Pagesa tatim paga/sigurimesh	382,673	266,075
Pagesa utilitetesh	50,127	65,675
Pagesa tatimi ne burim	-	24,957
Fatura të pambërritura (energji, ujë, ngrohje)	193,845	75,718
Totali	626,645	432,425

9. Të Ardhurat

Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2014 dhe 2013 janë si vijon:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Nga kuotizacionet e Bankave Anëtare	33,000,000	33,001,000
Interesa nga llogaritë rrjedhëse	11,398	9,073
Të ardhura të tjera	876,406	6,567,040
Totali	33,887,804	39,577,113

Me vendim Asambleje Nr. 6, datë 31.05.2011, bankat anëtare paguajnë shuma të ndryshme, në proporcion me përqindjen që zënë asetet e tyre në totalin e aseteve të sistemit bankar (kuotë proporcionale), me një vlerë minimale të kuotave prej 1.000.000 Lek.

Të ardhurat e tjera përfshijnë kryesisht tarifa trajnimesh të organizuara nga AAB.

10. Shpenzimet e Përgjithshme dhe të Administrimit

Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit në 2014 dhe 2013 përbëhen nga sa vijon:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Shpenzime personeli	11,357,540	10,329,521
Shpenzime të tjera të administrimit	14,974,511	29,233,937
Totali	26,332,051	39,563,458

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Paga dhe Shpërblime	9,752,665	9,019,862
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,015,675	865,659
Sigurim Shëndetësor SIGAL	589,200	444,000
Totali	11,357,540	10,329,521

NOTES ON THE FINANCIAL STATEMENTS

Shpenzimet e tjera të administrimit paraqiten si më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Shpenzime për Zyrat e reja	419,716	-
Shërbime utilitare	4,682,475	5,420,069
Shpenzime trajnimi për Bankat Anëtare	988,207	6,273,000
Shpenzime organizative	3,359,775	4,544,251
Publikime dhe internet	3,788,968	4,706,957
Shpenzime zyre	1,664,255	1,525,394
Shërbime konsulence	-	6,628,891
Komisione & tarifa bankare	60,995	125,255
Taksa vendore	10,120	10,120
Totali	14,974,511	29,233,937

11. Fitim / humbja nga kursi i këmbimit

Nga diferencat në kurset e këmbimit, gjatë vitit 2014 është realizuar fitim prej 313 Lekësh.

